POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Mediat ndërkombëtare jahonë lajmit për mbylljen e TikTok në Shqipëri, heshtë kompania kineze
2 TikTok do mbyllet për 1 vit në Shqipëri, Rama: Rrugaçejt, promovon zhurnë e krimi footitut për familjet në konflikt me ligjin
3 Nata e ndërrimit të vitave në Durrës, bullgarët e polakët kryesojnë rezervimet në hotelet Operatori turistik: Çmimet u rritën me 10%
4 Mero Baze: Pse Flamur Noka po betohet te 'nuk merret peng'?
5 Dronët godasin ndërtesa të larta në Kazan të Rusisë

Kronikë

Korçë/ Shpërndanin kokainë në doza, arrestohen 4 persona, mes tyre një turk! Sekuestrohet 1 pistoletë, 57 gr kokainë dhe rreth 9 mijë euro

Policia e Korçës ka arrestuar 4 persona, mes tyre një turk, pasi shpërndanin kokainë në doza. Si pasojë e kontrolleve të ushtruara është sekuestruar 1 pistoletë, kokainë, rreth 9 000 euro dhe 3 pasaporta biometrike dhe 1 makinë.

Paratë e sekuestruara

Redaksia
21 Dhjetor, 10:13 | **Përditesimi: 21 Dhjetor, 10:35**

Share

Korçë-Policia e Korçës ka arrestuar 4 persona, mes tyre një turk, pasi shpërndanin kokainë në doza.

Specialistët e Sektorit për Hetimin e Narkotikëve në policinë e Korçës, pas informacionit të marrë në rrugë operative për disa persona nga Rrogozhina që udhëtonin në drejtim të Korçës për të cilët dyshohej se po transportonin lëndë narkotike, për një automjet me targa të huaja që ishte i shpallur alert nga Interpol Roma, automjet me të cilin mund ta përdorin shtetasit që dyshoheshin për shpërndarje kokaine, kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Koordinimi".

Në kuadër të operacionit në hyrje të qytetit të Korçës shërbimet e Policisë kanë ndaluar automjetin e dyshuar tip Benz me targa të huaja që drejtohej nga Ajet Desari, automjet në të cilin udhëtonin dhe tre shtetas të tjerë një person i cili është nga Turqia, një e mitur 17 vjeçe dhe një 34 vjeçar.

LEXO EDHE:
Itali/ Do trafikonin 2 kg kokainë, arrestohen shqiptari dhe italiani! U sekuestrohen edhe hashash e valutë

Policia ka sekuestruar 1 armë zjarri pistoletë , 57 gramë kokainë, rreth 9000 euro, 5 aparate celulare, 3 pasaporta biometrike dhe një automjet.

> *'Nga veprimet hetimore të kryera nga Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Korçë, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: Ajet Desari, 40 vjeç, banues në Rrogozhinë, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" e kryer në bashkëpunim dhe "Trafikimi i mjeteve motorike". Shtetasit turk Osman Çakir, 44 vjeç, për veprat penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve" e kryer në bashkëpunim dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municioneve". Edison Xhani, 34 vjeç, banues në Rrogozhinë dhe një 17-vjeçare për veprën penale 'Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", e kryer në bashkëpunim', njoftoi sot policia.*

Policia ka proceduar penalisht dhe një person që dyshohet i implikuar në këtë veprimtari, G. K., 20 vjeç, banues në Rrogozhinë, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" e kryer në bashkëpunim.

Nën drejtimin e Prokurorisë vijon puna për dokumentimin e plotë ligjor të këtij rasti. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

S.B/Shqiptarja.com

TAG: Osman Çakir | Ajet Desari | Edison Xhani | kokainë | Korce | policia e korces

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
21 Dhjetor, 15:03
Si e vlerësoni mbylljen e TikTok në Shqipëri për një vit?
Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Itali/ Trafik kokaine nëpërmjet 'WatsApp', kapet në ndjekje 23-vjeçari shqiptar! I sekuestrohen armë dhe euro cash
21 Dhjetor, 19:39

Emigrantët kthehen në Shqipëri për festa, fluks në Kapshticë
21 Dhjetor, 10:30

Kujtohet në vendlindje Lasgush Poradeci, bojkoton e bija! Aktivitet kulturor për 125 vjetorin e lindjes së poetit
20 Dhjetor, 16:49

Kampionati kombëtar i fluturimeve 'Korça Open Air'! Pjesëmarrës 40 pilotë nga shtete të ndryshme
Armand Braho
20 Dhjetor, 16:39

Itali/ Po trafikonin 60 kg kokainë të fshehura në makinë, arrestohen 3 shqiptarët
20 Dhjetor, 16:02

Pogradec/ Policia dhe Inspektoriati i peshkimit sekuestrojnë varkën në liqen, autorët e braktisën! Sekuestrohet edhe 300 metra rrjetë
Armand Braho
20 Dhjetor, 14:24

Çmontohet organizata shqiptare që kontrabandonte drogë nga Belgjika drejt Britanisë, mbi 30 kontrolle banesash dhe disa të arrestuar
18 Dhjetor, 18:49

S'ka më koran në Pogradec, ndalohet gjuetia për tre muaj! Në restorante vetëm peshk i ngrirë
Armand Braho
18 Dhjetor, 16:47

Korçë/ Shiste fishekzjarre kontrabandë, vihet nën hetim pronarja e subjektit (VIDEO)
18 Dhjetor, 10:05

Mjegulla mbulon Korçën dhe akset nacionale, policia apel shoferëve: Qarkulloni me shpejtësi të reduktuar (VIDEO)
18 Dhjetor, 09:18

Korçë/ Përfshihet nga flakët banesa, shkak një shkëndijë elektrike! Shkrumbohet nga zjarri edhe një shtëpi në Kolonjë! Shpëtojnë familjarët (VIDEO)
18 Dhjetor, 09:13

Greqi/ Kapen 82 kg kokainë në Portin e Pireut, arrestohen dy punonjës të portit
17 Dhjetor, 22:31

HOROSKOPI
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje